



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE*  
*MINISTRY OF FINANCE*

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting  
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar  
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

## **SKK 15**

### **Pasuritë e paprekshme**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij standardi është përshkrimi i trajtimit kontabël të pasurisë së paprekshme me të cilën nuk është marrë në mënyrë specifike asnjë standard i kontabilitetit të Kosovës. Ky standard kërkon që ndërmarrja të njoh pasurinë e paprekshme nëse, dhe vetëm nëse, përmbushen kriteret e caktuara. Standardi poashtu specifikon si të matet shuma e regjistrimit të pasurisë së paprekshme dhe kërkon shpalosje të duhura lidhur me pasurinë e paprekshme.

#### **Fushëveprimi**

1. Ky standard duhet të përdoret nga të gjitha ndërmarrjet në kontabilitet për pasuri të paprekshme, përveç për:
  - (a) Pasuritë e tatimit të shtyrë (shih SKK 12 “Tatimet mbi fitimin”)
  - (b) Lizingjet që ndodhen brenda fushëveprimit të SKK 13 “Lizingët”
  - (c) Pasuria financiare siç diskutohet në SKK 14 “Instrumentet financiare”

2. Ky standard përveç tjerash, përdoret për, të dalat nga aktivitetet hulumtuese dhe zhvillimore. Aktivitetet hulumtuese dhe zhvillimore drejtohen në zhvillimin e diturisë.

### **Përkufizimet**

3. Termet vijuese në këtë standard përdoren me këto kuptime të caktuara:

**Pasuria e paprekshme** është pasuria jomonetare e identifikueshme si e paprekshme që mbahet për t'u përdorur në prodhimin ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për dhënie me qira, ose për qëllime administrative.

**Pasuria** është burim:

- (a) që kontrollohet nga ndërmarrja si rezultat i ngjarjeve të kaluara; dhe
- (b) nga i cili pritet që dobitë e ardhme ekonomike të derdhen në ndërmarrje.

**Pasuritë monetare** janë paratë që mbahen dhe pasuria që do të pranohet në shuma fikse ose të përcaktueshme të parave.

**Hulumtimi** është hetim burimor dhe i planifikuar që ndërmerret me qëllim që të arrihen dhe të kuptohen dituritë e reja shkencore ose teknike.

**Zhvillimi** është zbatimi i zbulimeve kërkimore ose të njohurive të tjera për të planifikuar ose projektuar prodhimin e materialeve të reja ose kryesisht të përmirësuara, pajisjeve, produkteve, proceseve, sistemeve ose shërbimeve para fillimit të prodhimit ose përdorimit komercial.

**Amortizimi** është akordimi sistematik i shumës së amortizueshme të pasurisë së paprekshme gjatë afatit të saj të përdorimit.

**Shuma e amortizueshme** është kostoja e një pasurie, ose një shumë tjetër që zëvendësohet për kosto në pasqyrat financiare, minus shuma e saj e mbetur.

**Jeta e përdorimit** është:

- (a) periudha kohore në të cilën pritet që një pasuri të përdoret nga ndërmarrja, ose
- (b) numri i produkteve ose i njësive të ngjashme të cilat pritet t'i sendërtoj ndërmarrja nga ajo pasuri.

**Kostoja** është shuma e paguar e parasë ose vlera fer e kompensimeve tjera të dhëna për të siguruar një pasuri në kohën e marrjes ose prodhimit të saj.

**Vlera e mbetur** është vlera neto që ndërmarrja pret të marrë për një pasuri në fund të jetës së përdorimit pas zbritjes së kostove të pritura të heqjes nga përdorimi.

**Vlera fer** e një pasurie është vlera për të cilën ajo pasuri mund të këmbetet midis të njohurve, palëve të gatshme për transaksion “duarlibër”.

**“Transaksion duarlibër”** është një transaksion në mes të dy palëve jo të ndërlidhura; në të cilin secila palë vepron sipas interesit të vet personal.

**Tregu aktiv** është tregu ku ekzistojnë kushtet vijuese:

- (a) artikujt që këmbehen brenda tregut janë homogjenë;
- (b) blerësit dhe shitësit e gatshëm mund të gjenden normalisht në çdo kohë, dhe
- (c) çmimet janë në dispozicion të publikut.

**Humbja nga dëmtimi** është shuma nga e cila shuma e regjistrimit të pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme.

**Shuma e regjistrimit** është shuma me të cilën një pasuri njihet në pasqyrën e bilancit pas zbritjes së çdo amortizmi të akumuluar dhe humbjeve të akumuluar nga dëmtimi.

### **Pasuritë e paprekshme**

- 4. Ndërmarrjet shpesh harxhojnë burimet, ose marrin detyrime, për marrjen, zhvillimin, mirëmbajtjen ose shtimin e burimeve të paprekshme siç janë njohuria shkencore ose teknike dhe projektimi dhe implementimi i proceseve ose sistemeve të reja. Emërtimet e zakonshme të këtyre zërave janë softueri kompjuterik, patentet dhe të drejtat e autorit.
- 5. Nëse një zë nuk i përgjigjet përkufizimit të pasurisë së paprekshme, të dalat e marrjes ose gjenerimit të brendshëm kur të ndodh kjo, duhet të njihen si shpenzim.

### **Identifikueshmëria dhe kontrolli**

- 6. Përkufizimi i një pasurie të paprekshme kërkon që ajo pasuri të jetë e identifikueshme dhe nën kontroll të ndërmarrjes.

7. Pasuria e paprekshme është e identifikueshme nëse ajo është e ndashme. Pasuria është e ndashme nëse ndërmarrja mund të jap me qira, të shesë, të këmbej ose të shpërndajë dobitë e ardhme specifike ekonomike, të arritura nga ndarja e pasurisë nga pasuritë tjera të përdorura në aktivitetet e njëjta të fitimit të të hyrave.
8. Ndërmarrja kontrollon pasurinë nëse ndërmarrja ka forcë për të fituar në të ardhmen dobi ekonomike që rrjedhin nga burimi themelor dhe po ashtu mund të kufizojë qasjen të tjerëve në ato dobi. Kapaciteti i ndërmarrjes për të kontrolluar dobitë e ardhshme ekonomike nga pasuria e paprekshme duhet të buroj normalisht nga të drejtat ligjore që janë të plotfuqishme në gjyq.

### **Dobitë e ardhshme ekonomike**

9. Dobitë e ardhshme ekonomike të cilat rrjedhin nga pasuria e paprekshme, mund të përfshijnë të hyrën nga shitja e prodhimeve ose shërbimeve, kursimi i kostove, ose nga dobi të tjera që rezultojnë nga përdorimi i pasurisë nga ndërmarrja. Për shembull, përdorimi i pronës intelektuale në procesin e prodhimit mund të zvogëlojë kostot e ardhme të prodhimit ose të shtoj të hyrat në të ardhmen.

### **Njohja dhe matja fillestare e pasurisë së paprekshme**

10. Njohja e një zëri si pasuri paprekshme kërkon nga ndërmarrja që të demonstrojë se zëri përmbush sa vijon:
  - (a) përkufizimin e pasurisë së paprekshme, dhe
  - (b) kriteret e njohjes
11. Pasuria e paprekshme duhet të njihet nëse dhe vetëm nëse:
  - (a) është e besueshme se dobitë e ardhshme ekonomike që i atribuohen pasurisë, do të rrjedhin në ndërmarrje, dhe
  - (b) kostoja e pasurisë mund të matet në mënyrë të besueshme
12. Ndërmarrja duhet të vlerësojë gjasën e dobive të ardhshme ekonomike duke përdorur supozime të arsyeshme dhe përkrahëse që pasqyrojnë vlerësimet më të mira të menaxhmentit për vendosjen e kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së përdorimit të pasurisë.
13. Pasuria e paprekshme fillimisht duhet të matet sipas kostos.

### **Marrja e ndarë**

14. Nëse pasuria e paprekshme është fituar ndarazi, kostoja e pasurisë së paprekshme zakonisht mund të matet me besueshmëri. Kjo është veçanërisht kështu kur konsiderata e blerjes është në formë të parave të gatshme ose pasurive të tjera monetare.
15. Kostoja e pasurisë së paprekshme përbën çmimin e blerjes së saj, përfshirë çdo tatim të pakthyeshëm, dhe të dalat që atribuohen drejtpërdrejtë në përgatitjen e pasurisë për përdorimin e saj të caktuar. Të dalat e atribueshme drejtpërdrejt përfshijnë, për shembull, tarifat profesionale për shërbime ligjore. Çdo zbritje dhe rabat tregëtar hiqet me rastin e arritjes së koston.

### **Pasuritë e paprekshme të gjeneruara përbrenda**

16. Ndonjëherë është vështirë të vlerësohet se kur një pasuri paprekshme e gjeneruar përbrenda cilësohet për njohje. Shpesh është vështirë e të identifikohet nëse, dhe paraqitet një pasuri e identifikueshme që do të gjeneroj dobi ekonomike të mundshme në të ardhmen, si dhe koha kur do të ndodh kjo. Prandaj, në vazhdim në përputhje me kërkesat e përgjithshme për njohjen dhe matjen fillestare të pasurisë së paprekshme, ndërmarrja zbaton kërkesat dhe udhëzimet vijuese për të gjitha pasuritë e paprekshme të gjeneruara përbrenda.
17. Për të vlerësuar se kur një pasuria e paprekshme e gjeneruar përbrenda përmbush kriteret për njohje, ndërmarrja krijimin e pasurisë e klasifikon në:
  - (a) fazën e kërkimit, dhe
  - (b) fazën e zhvillimit
18. Nëse ndërmarrja nuk mund të dallojë fazën e kërkimit nga faza e zhvillimit të projektit të brendshëm për të krijuar pasuri të paprekshme, ndërmarrja të dalat në atë projekt i trajton sikur të kishin ndodhur vetëm në fazën e kërkimit.

### **Faza e kërkimit**

19. Asnjë pasuri paprekshme që rrjedh nga kërkimi nuk duhet të njihet. E dala nga kërkimet duhet të njihet si një shpenzim kur ai ndodh.
20. Shembull i aktiviteteve kërkimore janë:

- (a) aktivitetet me qëllim të fitimit të diturisë së re
- (b) kërkimi për vlerësimin, zgjedhjen finale të zbatimit të zbulimeve kërkimore ose të një njohurie tjetër
- (c) kërkimi i alternativave për materiale, pajisje, produkte, procese, sisteme ose shërbime
- (d) formulimi, projektimi, vlerësimi dhe zgjedhja finale e alternativave të mundshme për materiale, pajisje, produkte, procese, sisteme ose shërbime të reja ose të përmirësuara.

### **Faza e zhvillimit**

21. Pasuria paprekshme e krijuar nga zhvillimi duhet të njihet, nëse dhe vetëm nëse, ndërmarrja mund të demonstrojë të gjitha këto:
- (a) zëvendësimin e plotë teknik të kompletimit të pasurisë së paprekshme ashtu që do të jetë e gatshme për përdorim ose shitje
  - (b) aftësinë dhe qëllimin e tij për të kompletuar pasurinë e paprekshme dhe përdorimin ose shitjen e saj
  - (c) si do të krijojë dobi ekonomike të mundshme në të ardhmen pasuria e paprekshme. Midis të tjerash, ndërmarrja duhet të demonstrojë ekzistimin e tregut për prodhimet e pasurisë së paprekshme ose për vetë pasurinë e paprekshme ose, nëse do të përdoret përbrenda, për dobishmërinë e pasurisë paprekshme
  - (d) aftësinë e tij për të matë me besueshmëri të dalën që i atribuohet pasurisë së paprekshme gjatë zhvillimit të saj
22. Në fazën e zhvillimit të projektit, në disa raste, ndërmarrja mund, të identifikojë pasurinë e paprekshme dhe të demonstrojë se ajo pasuri do të krijojë dobi ekonomike të mundshme në të ardhmen. Kjo është për arsye se faza e zhvillimit të projektit është më e përparuar se sa faza e kërkimit.
23. Shembuj të aktiviteteve zhvillimore janë:
- (a) Projektimi, konstruktimi dhe testimi i paraprodhimit ose i prototipeve dhe i modeleve përpara përdorimit;
  - (b) Projektimi, konstruktimi dhe testimi i alternativave të zgjedhura për materiale pajisje, produkte, procese, sisteme ose shërbime të reja ose të përmirësuara.

24. Për të demonstruar se si pasuria e paprekshme do të krijojë dobi ekonomike të mundshme në të ardhmen, ndërmarrja vlerëson që të merren dobi të ardhshme ekonomike nga pasuria. Një metodë e vlerësimit është vlerësimi i rrjedhës së parasë së gatshme në të ardhmen bazuar në supozimet e arsyeshme dhe të mbështetura që pasqyron vlerësimin më të mirë të fundit të menaxhimit, të kushteve ekonomike të vendosura që do të ekzistojnë gjatë jetës së mbetur të përdorimit të pasurisë. Vlerësimi duhet të marrë parasysh shkallën e sigurimeve shtesë për rrjedhën e dobive ekonomike në bazë të dëshmisë në dispozicion.
25. Mundësia e sigurimit të burimeve për të kompletuar, përdorur dhe marrë dobi nga pasuria e paprekshme mund të demonstrohet nga plani i biznesit për shembull, që tregon burimet teknike, financiare të nevojshme dhe aftësinë e ndërmarrjes për t'i siguruar këto burime. Ndërmarrja mund të demonstrojë aftësi të financimit të jashtëm me marrjen e markës së huadhënësit për gadishmërinë e tij për të financuar planin.
26. Markat, titujt e publikimit, listat e klientëve dhe zërat e ngjashme në substancë të gjeneruar përbenda nuk duhet të njihen si pasuri paprekshme.

### **Kostoja e pasurisë sw paprekshme të gjeneruar përbrenda**

27. kostoja e pasurisë sw paprekshme të gjeneruar përbrenda është shuma e të dalave nga data kur pasuria e paprekshme për herë të parë përmbush kriteret e njohjes. Ndërmarrja e ka të ndaluar të rivendos së dalën që është njohur si një shpenzim në pasqyrat financiare vjetore të mëparshme ose në pasqyrat financiare të përkohshme.
28. Kostoja e pasurisë së paprekshme të gjeneruar përbrenda përfshin të gjitha të dalat që mund të atribuohen drejtpërdrejtë, ose të akordohen në bazë të arsyeshme dhe konsekuente, për të krijuar, prodhuar dhe përgatitur pasurinë me qëllim të përdorimit të saj. Kjo nëse mund të zbatohen përfshin:
- (a) të dalat nga materialet dhe shërbimet e përdorura ose të harxhuara në gjenerimin e pasurisë së partupëzuar;
  - (b) pagat dhe kostot tjera të punësimit lidhur me personelin e angazhuar drejtpërdrejtë në gjenerimin e pasurisë;
  - (c) çdo të dalë që i atribuohet drejtpërdrejt gjenerimit të pasurisë, siç janë tarifatat për të regjistruar të drejtën ligjore;

- (d) shpenzimet e përgjithshme e të nevojshme për gjenerimin e pasurisë dhe të cilat të alokohen në bazë të arsyeshme dhe konsekuente në pasuri.

Shpenzimet e përgjithshme të cilat janë të akorduara në koston e pasurisë së paprekshme të gjeneruar përbrenda, duhet të shpërndahen duke përdorur bazë të njëjtë si ajo e përdorur në përcaktimin e koston së patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve të vetë konstruktura.

29. Nuk janë përbërës të koston së pasurisë së paprekshme të gjeneruar përbrenda këto:
- (a) të dalat e shpenzimeve të përgjithshme të shitjes, të dalat e shpenzimeve të përgjithshme administrative dhe të dalat e shpenzimeve të tjera derisa këto të dala mund të atribuohen drejtpërdrejtë në përgatitjen e pasurisë për përdorim
- (b) të dalat për trajnimin e stafit që do të veprojnë me pasurinë.

### **Njohja e shpenzimit**

30. Të dalat e një zëri të paprekshëm duhet të njihet si shpenzim kur ndodh përderisa nuk formon pjesën e koston së pasurisë së paprekshme që përmbush kriteret e njohjes.

### **Të dalat pasuese**

31. E dalat pasuese të një pasurie të paprekshme pas blerjes ose kompletimit të saj, duhet të njihen si shpenzim kur ndodhin përveç nëse:
- (a) është e besueshme që kjo e dalë do të bëjë të mundshme që pasuria të gjenerojë dobi të ardhme ekonomike si tepricë e veprimtarisë së saj standarde të vlerësuar në mënyrë origjinale, dhe
- (b) kjo e dalë mund të matet dhe t'i atribuohet pasurisë në mënyrë të besueshme.

Nëse plotësohen këto kushte, e dala pasuese duhet t'i shtohet koston së pasurisë së paprekshme.

### **Matja që pasojnë pas njohjes fillestare**

32. Pas njohjes fillestare, pasuria e paprekshme duhet të regjistrohet në kostonë e saj minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dobësimi.



### Periudha e amortizimit

33. Shuma e amortizueshme e pasurisë së paprekshme duhet të akordohet në bazë sistematike sipas vlerësimit më të mirë të jetës së saj të përdorimit. Amortizimi duhet të filloj kur pasuria është në dispozicion për përdorim.
34. Vlerësimet e supozuara të jetës të përdorimit të pasurisë së paprekshme në përgjithësi bëhen më pak të besueshme me zgjatjen e jetës së përdorimit. Ky standard pranon supozimin se jeta e përdorimit e pasurisë së paprekshme vështirë se do të tejkaloj njëzet vjet.
35. Nëse kontrolli i dobive ekonomike në të ardhmen nga pasuria e paprekshme arrihet përmes të drejtave ligjore që janë dhënë për një periudhë të caktuar, jeta e përdorimit të pasurisë së paprekshme nuk duhet të tejkalojë periudhën e së drejtës ligjore vetëm në qoftë se:
  - (a) të drejtat ligjore janë ripërtëritur, dhe
  - (b) ripërtëritja është praktikisht e sigurt.

### Metoda e amortizimit

36. Metoda e amortizimit e përdorur duhet të reflektoj modelin në të cilin dobitë ekonomike të pasurisë konsumohen nga ndërmarrja. Nëse ai model nuk mund të caktohet në mënyrë të besueshme, duhet të përdoret metoda lineare. Ngarkimi i amortizimit për çdo periudhë duhet të njihet si shpenzim.

### Vlera e mbetur

37. Vlera e mbetur e pasurisë së paprekshme duhet të supozohet që të jetë zero vetëm nëse:
  - (a) ekziston zotimi nga një palë e tretë për të blerë pasurinë në fund të afatit të saj të përdorimit, ose
  - (b) ekziston një treg aktiv për pasurinë dhe
    - (i) vlera e mbetur mund të përcaktohet nga referenca për atë treg, dhe
    - (ii) është e mundshme që tregu i tillë do të ekzistojë deri në fund të jetës së saj të përdorimit të pasurisë

### **Shqyrtimi i periudhës së amortizimit dhe i metodës së amortizimit**

38. Periudha e amortizimit dhe metoda e amortizimit duhet të shqyrtohen së paku në çdo fundvit financiar. Nëse pritet që jeta e përdorimit të pasurisë të jetë mjaft e ndryshme nga vlerësimet e mëparshme, duhet të ndërrohet periudha e amortizimit në mënyrë përkatëse. Nëse ka pasur ndryshim të madh në modelin e pritur të dobi ekonomike të pasurisë, metoda e amortizimit duhet të ndërrohet për të reflektuar ndërrimin e modelit. Ndërrimet e tilla duhet të llogariten si ndryshime në vlerësimin kontabël në pajtim me SKK 5 “Fitimi ose humbja neto për periudhë, zërat e jashtëzakonshëm, gabimet fundamentale, ndryshimet në vlerësimin kontabil dhe ndryshimet në politikat kontabël”, duke harmonizuar ngarkimin e amortizimit për periudhat vijuese dhe të ardhme.

### **Dobësimi dhe rikuperimi i shumës së regjistrimit**

39. Për të përcaktuar se kur një pasuri e paprekshme dëmtohet, ndërmarrja përdor SKK 3 “Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet”. Ai standard sqaron se si ndërmarrja shqyrton shumën e regjistrimit të pasurisë së saj, si e përcakton shumën e rikuperuar të pasurisë dhe kur e njeh atë ose e kthen në humbje nga dëmtimi.

### **Vjetrimi dhe heqja nga përdorimi**

40. Pasuria e paprekshme duhet të eliminohet nga pasqyra e bilancit në heqjen nga përdorimi ose kur nuk priten dobi ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i saj ose kur hiqet nga përdorimi.
41. Fitimet ose humbjet që krijohen nga vjetrimi ose nga heqja nga përdorimi i pasurisë së paprekshme duhet të përcaktohen si ndryshim midis parave neto të hequra nga përdorimi dhe shumës së regjistrimit të pasurisë dhe duhet të njihet si e ardhur ose si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave.

### **Shpalosja**

42. Pasqyrat financiare duhet të shpalosin si vijon për çdo lloj të pasurisë sw paprekshme, duke bërë dallimin midis pasurisë sw paprekshme të gjeneruar përbrenda dhe pasurisë tjetër tw paprekshme:
- (a) jetërat e përdorimit ose shkallën e amortizimit të përdorur;
  - (b) metodat e përdorura të amortizimit;
  - (c) shumën bruto të regjistrimit dhe amortizimin e akumuluar në fillim dhe në fund të periudhës;

- (d) zërin(at) e renditur në pasqyrën e të ardhurave në të cilin përfshihet amortizimi i pasurisë së paprekshme;
  - (e) harmonizimin e shumës së regjistrimit në fillim dhe në fund të periudhës duke treguar:
    - (i) vjetrimet dhe heqjet nga përdorimi;
    - (ii) humbjet nga dëmtimi të njohura ose të kthyer prapa në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës;
    - (iii) amortizimin e njohur gjatë periudhës;
    - (iv) ndryshimet e tjera në shumën e regjistrimit gjatë periudhës.
43. Pasqyrat financiare duhet të shpalojnë poashtu përshkrimin e shumës së regjistrimit dhe periudhën e mbetur të amortizimit të çdo pasurie të paprekshme veç e veç që është materiale për pasqyrat financiare të ndërmarrjes si tërësi.

#### **Dispozita e përkohshme**

45. Më datën kur hyn në fuqi ky standard, dhe ndërmarrja do të shqyrtojë pasurinë e paprekshme të tij të njohur më parë, nëse pasuria e paprekshme e njohur më parë plotëson kriteret e njohjes dhe të matjes në pajtim me këtë standard, kjo duhet të llogaritet në mënyrë përkatëse. Nëse pasuria e paprekshme e njohur më parë nuk plotëson kriteret e njohjes dhe të matjes në këtë standard, ajo duhet të shlyhet në pajtim me SKK 5 "Fitimi ose humbja neto për periudhën, zërat e jashtëzakonshëm, ndryshimet në vlerësimin kontabil, ndryshimet në politikën kontabile dhe gabimet fundamentale".

#### **Data e hyrjes në fuqi**

46. Ky standard do të hyjë në fuqi për pasqyrat financiare që u përkasin periudhave prej 1 janar 2002 apo pas tyre.